



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Up1 nr.11-141

10.05.2022

Sh k u p

Bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr 84/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20 dhe 77/21), në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 i po të njëjtit Ligj, pika 8 i Rregullores për përcaktimin e afatit për të vepruar sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015., Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-1894/1 nga 05.05.2022. dhe Konkluzën ark.nr.02-1904/3 nga 09.05.2022., Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 17-të, e mbajtur më 09.05.2022., miratoi si më poshtë:

Vendim

për vërejtje publike dhe për përjashtim nga transmetimi i shërbimit programor

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për telekomunikacion SKUPI KABLE SHPK Shkup, për ritransmetim të shërbimit programor i cili nuk është i regjistruar në Agjencinë për shërbime programore audio dhe audiovizuele në pajtim me nenin 141 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele. Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-1894/1 nga 05.05.2022., e cila është pjesë plotësuese e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.
2. OBLIGOHET operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik Shoqëria për telekomunikacion SKUPI KABLE SHPK Shkup, menjëherë pas marrjes së vendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga Jigji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, pra të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore,
3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrur i cekur në pikën 1 të vendimit, ka vepruar sipas vendimit për vërejtje publike dhe ndërprerje të ritransmetimit të shërbimeve programore.
4. Nëse subjekti i mbikëqyrur i cekur në pikën 1 të vendimit, nuk vepron sipas vendimit dmth vazhdon me shkelje edhe pas paralajmërimit, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në pajtim me nenin 23 paragrafin 1 alinea 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, të paraqesë kërkesë për të inicuar procedurë kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente.
5. Ky Vendim është përfundimtar, dhe si datë e miratimit të tij do jetë data e verifikimit në arkivin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

A r s y e t i m

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Agjencioni) në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 alinea 4 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (LSHMAAV)

morri masë në pajtim me këtë ligj në rastet kur bëhet shkelje e dispozitave nga LSHMAAV ose të normave të miratuara me Ligj si dhe kushteve e detyrimeve për leje.

Bazuar në nenin 28 nga LSHMAAV, Agjencia ka kompetencë të kryejë mbikëqyrje kontrolli (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve programore sipas kërkesës si dhe të paketave programore që i ritransmetojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave të Ligjit, lejeve, vërtetimeve të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akteve të tjera të Agjencisë.

Në kuadër të kompetencave të saja Ligjore, dhe në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 nga LSHMAAV Agjencia më 05.05.2022., ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore ndaj shërbimeve programore të ritransmetuara nga operatori i Shoqërisë së telekomunikacionit SKUPI KABLE SHPK Shkup, ku konstatoi se operatori në fjalë pas njoftimit nga Agjencia për komunikim elektronik të komunës Araçinë të Shkupit, më 05.05.2022. për përdoruesit e tij ritransmetonte shërbime programore që nuk janë të përfshira me vendim në regjistrin e shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, dhe bie në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë të cekura detajisht në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.11-1894/1 nga 05.05.2022., si pjesë plotësuese e këtij vendimi si Shtojca nr. 1.

Bazuar sipas nenit 18 paragrafi 1 alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 të Ligjit, pika 8 e Rregullores për përcaktim të afatit për të vepruar mbi vendimin e Agjencisë për shqiptim të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-1894/1 nga 05.05.2022., dhe Konkluzën ark.nr.02-1904/3 nga 09.05.2022., për konstatim të mosrespektimit të dispozitave nga LSHMAAV të cekura në pikën 1. të këtij vendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi vendim, ku subjektit të mësipërm ti shqiptohet masë vërejtje publike dhe obligohet menjëherë pas pranimi të vendimit të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore dhe të harmonizojë punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV, në mënyrë që do të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore.

Agjencia do kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti ka vepruar sipas urdhrit, dmth pas vërejtjes publike dhe ka ndërprerë me ritransmetim të shërbimeve programore.

Në pajtim me nenin 24 nga LSHMAAV, ku vendim është përfundimtar dhe ndaj tij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të paraqesë padi për kontekst administrativ pranë gjykatës kompetente. Padinë për kontekst administrativ do të dorëzohet në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua vendim si në dispozitiv.



Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të paraqesë kontekst administrativ pranë gjykatës kompetente. Padinë për kontekst administrativ paraqitet në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-1894/1 nga 05.05.2022.

Dorëzuar tek:

- Shoqëria për telekomunikacion SKUPI KABLE SHPK Shkup;
- Administrator/personit përgjegjës i Shoqërisë për telekomunikacion SKUPI KABLE SHTR Shkup;
- Sektori për planifikim strategjik dhe mbrojtja e të drejtave autoriale;
- Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik;
- Persona të autorizuar në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për udhëheqjen e Up1 dhe
- Agjencia e komunikimit elektronik në RMV.

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Bazuar në nenin 28 paragrafi 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe Ligji për ndryshim të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20 dhe 77/21), u dorëzua

RAPORT ME SHKRIM PËR MBIKËQYRJEN E KRYER PROGRAMORE

Република Северна Македонија
РЕПУБЛИКА СЪ МАКЕДОНИЈА
АГЕНЦИЈА ЗА АУДИО И АУДИОВИЗУЕЛНИ
СЛУЖБИ
АГЕНЦИЈА ЗА АУДИО И АУДИОВИЗУЕЛНИ
СЛУЖБИ
АГЕНЦИЈА ЗА АУДИО И АУДИОВИЗУЕЛНИ
СЛУЖБИ

Примено / Пријат: 05.05.2022

Оп. ознака / № на акт	Епис Публик	Плати Штатс	Број на Виде
11	1894	1	

1. Mbikëqyrja programore kryhet si: e rregullt
2. Subjekti i mbikëqyrur: Shoqëria e telekomunikacionit SKUPI KABLE SHPK Shkup
3. Data e mbarimit të mbikëqyrjes: 05.05.2022.
4. Objekti i mbikëqyrjes:

Mbikëqyrja kryhet për zbatimin e detyrave të përcaktuara sipas neneve në vijim nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe ligjit për ndryshim të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20 dhe 77/21):

4.1. neni 64 paragrafi 2 „Derisa shërbimet programore që ritransmetohen nëpërmjet rrjeteve publike të komunikimit elektronik janë titruar në një gjuhë tjetër nga gjuha që janë prodhuar fillimisht, duhet të jenë të titruara në gjuhën maqedonase, ose në gjuhën e komunitetit që për momentin nuk është shumicë, por e flasin së paku 20% e popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përveç tele-shoppingut dhe reklamave”.

4.2, neni 141 paragrafi 13 - „Derisa Agjencia në bazë të mbikëqyrjes së kryer programore në pajtim me ligjin përcaktoi se operatori ka ritransmetuar shërbime programore që nuk janë të regjistruara si shërbime programore në këtë ligj, Agjencia në afat kohor prej shtatë ditësh nga mbikëqyrja e kryer programore miraton vendim ku do të kërkojë nga operatori që menjëherë të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore”.

5. Masa paraprake të shqiptuara: skemi

1



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

6.Konstatime nga mbikëqyrja:

Nga mbikëqyrja u konstatua se Shoqëria e telekomunikacionit SKUPI KABLE SHTR Shkup, sipas informatave nga Agjencia për komunikim elektronik mund të kryejë veprimtarinë e saj në Komunën e Aračinës dhe Shkup, më 05.05.2022 për përdoruesit e saj ka ritransmetuar shërbimin programor „IN TV”, e cila nuk mbulohet me vërtetim për regjistrim në shërbimet programore e dhënë nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, dhe bie në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale

MASA E PROPOZUAR:

1. Drejtori i Agjencisë t’i propozojë Këshillit miratimin e vendimit me të cilën Shoqërisë së telekomunikacionit SKUPI KABLE SHTR Shkup t’i shqiptojë masë vërejtje publike dhe menjëherë pas marrjes së vendimit, në pajtim me

pikën 8 të Rregullores për përcaktim të afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) nr,01-6039/1 nga 20.10.2015 të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, dmth të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore që nuk janë të regjistruar në Agjenci.

2. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse operatori ka vepruar sipas paralajmërimit (pjesërisht ose plotësisht), pas skadimit të afatit të përcaktuar në vendim e miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

3. Vendimi nga pika 1 të dorëzohet në Agjencinë për komunikim elektronik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sektori për mbrojtjen e të drejtave autoriale, Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtave autoriale

ACC x!

2

Lista e subjekteve të njohura

Почетен датум: /
Географско подрачје: /
Тип на нотификација: /

emërtimi: Shoqëria e telekomunikacionit SKUPI KABEL SHPK Shkup rruga. Tale Hristov BB Shkup

Operatori	Rrjeti/Shërbim	Lloji i shërbimit	Zona gjeografike	Lloji i rrjetit	Data e shërbimit	Data e përfundimit
SKUPI OBLE SHPK Shkup	Rrjeti publik kabllorik	Zona lokale gjeografike	Araçinë	Pronësi	15.09.2015	
SKUPI OBLE SHPK Shkup	Shërbime për bartjen e të dhënave	Qasje më e qartë gjithpërfshirëse e internetit (shpejtësia bitska ndërmjet y 256 kbit/s dhe 30 MB S	Araçinë		15.09.2015	
SKUPI KABLE SHPK Shkup	Shërbime lidhur me transmetuesin	Ritransmetim të shërbimeve televizive programore	Araçinë		15.09.2015	
SKUPI OBLE SHPK Shkup	Shërbime për bartjen e të dhënave	Qasje më e qartë gjithpërfshirëse e internetit (shpejtësia bitska ndërmjet y 256 kbit/s dhe 30	Shkup		01.01.2014	
SKUPI OBLE SHPK Shkup	Rrjeti publik kabllorik	Zona lokale gjeografike	Shkup	Pronësi	01.07.2011	
SKUPI OBLE SHPK Shkup	Shërbime lidhur me transmetuesin	Ritransmetim të shërbimeve televizive programore	Shkup		01.07.2011	

Vërtetuar nga Agjencia për komunikim elektronik më datë:
05.05.2022

